



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

SPECIFIKIME TEKNIKE

Blerje lëndë djegëse, karburant (Naftë,benzinë)

Në zbatim të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Drejtorit nr. _____, datë _____.2026, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e testimit të tregut, përllogaritjen e fondit limit dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës për procedurën me objekt ‘Blerje lëndë djegëse, karburant (gazoil dhe benzinë pa plumb)’”, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, bazuar në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2026, hartoi këto specifikime teknike.

Specifikimet teknike të mëposhtme paraqesin kërkesat minimale të Autoritetit Kontraktor. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë produkte ekuivalente ose me karakteristika teknike më të mira, me kusht që ato të përmbushin funksionalitetin dhe kërkesat minimale të përcaktuara në këto specifikime.

Hartimi i këtyre specifikimeve teknike është kryer në respektim të parimeve të transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Hartimi i specifikimeve teknike për gazoilin dhe benzinën pa plumb është bërë në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; VKM-në nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, e ndryshuar; VKM-në nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngëta për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor”; VKM-në nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, e ndryshuar; si dhe standardet shqiptare në fuqi.

Lëndët djegëse objekt prokurimi duhet të jenë në përputhje me standardet shqiptare të adoptuara nga standardet evropiane (EN), të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, ose me standarde të tjera ekuivalente të njohura sipas legjislacionit në fuqi. Për gazoilin për automjete zbatohet standardi SSH EN 590:2025 ose ekuivalent; për gazoilin për kalaja zbatohen kërkesat e VKM-së nr. 429/2019 dhe treguesit e cilësisë të përcaktuar në këto specifikime, referuar standardit SSH EN 590:2025 ose ekuivalent; ndërsa për benzinën pa plumb zbatohet standardi SSH EN 228:2025 ose ekuivalent.

LOTI I

Blerje gazoil për automjete

Kërkesa teknike	Specifikimi minimal
Lloji i karburantit	Gazoil për automjete.
Standardi	SSH EN 590:2025, “Lëndë djegëse për automjete – Gazoil (Diezel) – Kërkesat dhe metodat e provës”, ose ekuivalent.
Përdorimi	Për automjete të pajisura me motor me ndezje me kompresion.
Cilësia	Karburanti duhet të jetë në përputhje me kërkesat e standardit SSH EN 590:2025 ose ekuivalent dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.
Gjendja	Karburanti duhet të jetë i pastër, homogjen, pa ujë të lirë, sedimente, papastërti mekanike ose ndotës të tjerë që mund të ndikojnë në funksionimin normal të motorit.
Përputhshmëria	I përshtatshëm për përdorim në automjetet e Autoritetit Kontraktor.
Tregtimi	Karburanti duhet të tregtohet nga operatorë ekonomikë të licencuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
Ruajtja dhe transporti	Karburanti duhet të ruhet dhe transportohet në kushte që garantojnë ruajtjen e karakteristikave cilësore të karburantit.
Dokumentacioni	Me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, karburanti duhet të shoqërohet me dokumentacion që vërteton përputhshmërinë me standardin e kërkuar.

LOTI II

Blerje gazoil për kaldaja

Kërkesa teknike	Specifikimi minimal
Lloji i karburantit	Gazoil për kaldaja.
Standardi	Kërkesat e VKM-së nr. 429/2019 dhe, për treguesit e cilësisë të përcaktuar në këto specifikime, standardi SSH EN 590:2025 ose ekuivalent.
Përdorimi	Për përdorim në sistemet e ngrohjes me kaldaja të Autoritetit Kontraktor.
Cilësia	Karburanti duhet të përmbushë kërkesat e VKM-së nr. 429/2019, treguesit e cilësisë të përcaktuar në këto specifikime, referuar standardit SSH EN 590:2025 ose ekuivalent, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.
Gjendja	Karburanti duhet të jetë i pastër, homogjen, pa ujë të lirë, sedimente, papastërti mekanike ose ndotës të tjerë që mund të ndikojnë në procesin e djegies dhe funksionimin normal të kaldajave.
Përputhshmëria	I përshtatshëm për përdorim në kaldajat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dokumentacionin teknik të pajisjeve ekzistuese.
Tregtimi	Karburanti duhet të tregtohet nga operatorë ekonomikë të licencuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
Ruajtja dhe transporti	Karburanti duhet të ruhet dhe transportohet në kushte që garantojnë ruajtjen e karakteristikave cilësore të karburantit.
Dokumentacioni	Me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, karburanti duhet të shoqërohet me dokumentacion që vërteton përputhshmërinë me standardin e kërkuar.

LOTI III

Blerje benzinë pa plumb për automjete

Kërkesa teknike	Specifikimi minimal
Lloji i karburantit	Benzinë pa plumb për automjete.
Standardi	SSH EN 228:2025, “Lëndë djegëse për automjete – Benzinë automjetesh – Kërkesat dhe metodat e provës”, ose ekuivalent.
Përdorimi	Për përdorim në automjete të pajisura me motor me ndezje me shkëndijë.
Cilësia	Karburanti duhet të jetë në përputhje me kërkesat e standardit SSH EN 228:2025 ose ekuivalent dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.
Gjendja	Karburanti duhet të jetë i pastër, homogjen, pa ujë të lirë, sedimente, papastërti mekanike ose ndotës të tjerë që mund të ndikojnë në funksionimin normal të motorit.
Përputhshmëria	I përshtatshëm për përdorim në automjetet e Autoritetit Kontraktor.
Tregtimi	Karburanti duhet të tregtohet nga operatorë ekonomikë të licencuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
Ruajtja dhe transporti	Karburanti duhet të ruhet dhe transportohet në kushte që garantojnë ruajtjen e karakteristikave cilësore të karburantit.
Dokumentacioni	Me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, karburanti duhet të shoqërohet me dokumentacion që vërteton përputhshmërinë me standardin e kërkuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë gjatë zbatimit të kontratës përputhshmërinë e lëndëve djegëse të furnizuara me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, të marrë mostra dhe të kërkojë analizimin e tyre pranë ISHTI-t ose një laborator testues të akredituar. Në rast mospërputhjeje, kontraktori duhet të tërheqë dhe të zëvendësojë produktin pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, pa cenuar zbatimin e masave të tjera të parashikuara në kontratë dhe në legjislacionin në fuqi.